

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET

RUBRIKA I

Prezantimi i moduleve të trajnimit dhe zhvillimi i kapaciteteve të trajnuesve të Policisë së Shtetit mbi etikën dhe integritetin policor në Akademinë e Sigurisë

- **Rektori i Akademisë së Sigurisë:** “Modulet e trajnimit do të ndihmojnë çdo punonjës policie të jetë në gjendje të kuptojë rolin e policisë në një shoqëri demokratike.”
- **Ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta:** “Paketa e moduleve të trajnimit mbështetet në modulet ekzistuese për etikën dhe integritetin policor dhe ofron një program të rishikuar dhe praktik për punonjësit e policisë të të gjitha gradave në të gjithë vendin.”
- **Përmbajtja e Moduleve mbi Etikën dhe Integritetin**

RUBRIKA II

Seria e takimeve llogaridhënëse publike për parandalimin e krimit

- **Bashkia Fier**
- **Bashkitë duhet të marrin gjithmonë e më shumë përgjegjësi në lidhje me sigurinë publike dhe Këshillat Bashkiakë nevojitet të jenë më të përfshirë në problemet e rendit dhe sigurisë publike.**

- **Shkolla luan një rol të rëndësishëm në edukimin e të rinjve për zbatimin e ligjit dhe respektimin e rregullave.**
- **Qytetarët: Nevojitet ndërveprim më i lartë ndërmjet Policisë dhe Bashkisë në rregullimin e qarkullimit rrugor urban dhe interurban.**
- **Bashkia Elbasan**
- **Bashkia Elbasan angazhohet në ngritjen e strukturave komunitare në të gjithë territorin e bashkisë si partnerë për mirëqeverisjen vendore.**
- **Prokuroria: Qytetarët duhet të informohen për funksionet e prokurorisë dhe policisë. Të përmirësohet edukimi ligjor i të rinjve.**
- **Duhet plane veprimi konkrete dhe ndëraktoriale për t’u përballur me figurat kryesore të krimit si vjedhja e banesave.**
- **Këshillat Vendor të Sigurisë Publike të mbështesin zgjidhjen e problemeve të evidentuara nga takimet llogaridhënëse.**
- **Ngritja e strukturave komunitare për një mjedis më të mirë për sigurinë publike**

RUBRIKA III

Vlerësim i autoriteteve vendore mbi nevojën e institucionalizimit të takimeve llogaridhënëse të trekëndëshit Bashki-Polici-Prokurori





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 6

Integritet Llogaridhënie

Partneritet

Mars 2020

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

Shënim:

Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.

PREZANTIMI I MODULEVE TË
TRAJNIMIT DHE ZHVILLIMI I
KAPACITETEVE TË TRAJNUESVE
TË POLICISË SË SHETIT MBI
ETIKËN DHE INTEGRITETIN
POLICOR NË AKADEMINË E
SIGURISË 4

PËRMBAJTJA E MODULEVE MBI
ETIKËN DHE INTEGRITETIN 9

NË FOKUS 10

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE
LLOGARIDHËNËSE PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT

Bashkia Fier: “Bashkitë duhet
të marrin gjithmonë e më
shumë përgjegjësi në lidhje
me sigurinë publike dhe
Këshillat Bashkiakë nevojitet
të jenë më të përfshirë në
problemet e rendit dhe
sigurisë publike” 10

Bashkia Elbasan angazhohet
në ngritjen e strukturave
komunitare në të gjithë
territorin e bashkisë si
partnerë për mirëqeverisjen
vendore 11

NGRITJA E STRUKTURAVE
KOMUNITARE PËR NJË MJEDIS
MË TË MIRË PËR SIGURINË
PUBLIKE 13

VLERËSIM I AUTORITETEVE
VENDORE MBI NEVOJËN E
INSTITUCIONALIZIMIT TË
TAKIMEVE LLOGARIDHËNËSE TË
TREKËNDËSHIT BASHKI-POLICI-
PROKURORI 13

ÇFARË TRAJTON KY NUMËR I BULETINIT?

Numri i radhës i Buletinit “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet” ka në fokus prezantimin e moduleve të Programit të trajnimit për etikën dhe integritetin policor për punonjësit e Policisë së Shtetit, të hartuar nga grupi i ekspertëve të IDM-së në bashkëpunim me grupin e punës së Akademisë së Sigurisë. Ky program do të ofrohet tashmë si pjesë e kurrikulave të trajnimit të vazhduar të Akademisë së Sigurisë.

Në këtë numër vijon rubrika e ndarjes së përvojës së takimeve llogaridhënëse publike në bashkitë Fier dhe Elbasan, me qëllim forcimin dhe institucionalizimin e bashkëpunimit Polici-Bashki-Prokurori me grupet e interesit dhe komunitetin në nivel vendor.

Një tjetër temë është edhe analiza e shkurtër mbi mundësitë e institucionalizimit të organizimit të takimeve llogaridhënëse periodikë të trekëndëshit Bashki – Polici – Prokurori. Kjo analizë mbështetet, ndër të tjera, në opinionin e mbledhur nga përfaqësuesit e institucioneve vendore të policisë, bashkisë dhe prokurorisë.

Mund të jepni kontributin tuaj me komente dhe shkrime për këtë buletin përmes komunikimit me botuesit tek info@idmalbania.org.



PREZANTIMI I MODULEVE TË TRAJNIMIT DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË TRAJNUESVE TË POLICISË SË SHTETIT MBI ETIKËN DHE INTEGRITETIN POLICOR NË AKADEMINË E SIGURISË

Për të pasur mbështetjen dhe besimin e publikut, Polica e Shtetit duhet të veprjë, krijojë e ruajë, imazhin e një organizate ku oficerët e policisë respektojnë dinjitetin njerëzor, në të gjitha veprimet e tyre.

Në një shoqëri demokratike dhe në një shtet ligjor, policia vepron për të garantuar sigurinë publike, zbatimin e ligjit si dhe për t'i shërbyer shoqërisë dhe publikut. Për misionin shumë të rëndësishëm të policisë është themelore përqafimi i vlerave, parimeve dhe standardeve për integritet të lartë institucional. Në këtë kontekst, grupi i ekspertëve të IDM-së në bashkëpunim me grupin e punës të Akademisë së Sigurisë hartoi një program trajnimi që synon të etikën dhe integritetin policor, duke inkurajuar punonjësit e Policisë së Shtetit që të krijojnë një organizatë etike dhe profesionale. Programi do të ofrohet si pjesë e kurrikulave të trajnimit të vazhduar të Akademisë së Sigurisë dhe ka për qëllim plotësimin e nevojës edukative të punonjësve të policisë me parimet dhe rregullat mbi integritetin policor institucional dhe individual. Programi i trajnimit përfshin katër module: 1. Moduli mbi përballjen me korrupsionin në Policinë e Shtetit; 2. Moduli për sjelljet policore- sjelljet e papërshtatshme pasojat dhe rëndësia e raportimit; 3. Moduli për imazhin profesional dhe kultura organizative policore; dhe 4. Kuadri ligjor dhe rregullator mbi integritetin policor. Në përfundim të këtij programi trajnimi punonjësit e policisë:

- Përfitojnë informacion mbi standardet e etikës, integritetit si dhe zbatimin e tyre në praktikë;
- Forcojnë njohuritë dhe aftësitë e kërkuara, me qëllim rritjen e efektivitetet në punë;
- Ndërgjegjësohen në lidhje me qëndrimet dhe sjelljet pozitive, pro-integritet.

Në muajin janar të vitit 2020 në Akademinë e Sigurisë, u prezantuan modulet e trajnimit për etikën dhe integritetin policor dhe u zhvillua sesioni i parë i trajnimit me lektorët e këtij institucioni. Në këtë takim morën pjesë drejtues dhe staf akademik i Akademisë së Sigurisë, Ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta si dhe ekipi i ekspertëve që u angazhuan bashkarisht me grupin e punës në Akademi për hartimin e këtij programi trajnimi.

FJALA HAPËSE E AMBASADORES SË VENDEVE TË ULËTA ZJ. GUUSJE KORTHALS ALTES NË AKTIVITETIN PREZANTUES TË MODULEVE TË TRAJNIMIT PËR ETIKËN DHE INTEGRITETIN POLICOR

Është një kënaqësi e madhe për mua të jem këtu. Jam e vetëdijshme që shumë fjalime përshëndetëse nisin me këtë fjali,



por më lejoni t'ju them se në këtë rast jam me të vërtetë e kënaqur të jem këtu duke qenë se ky është edhe fillimi i serisë së trajnimeve të punonjësve të policisë, të cilave ne u kushtojmë një rëndësi të veçantë.

Më lejoni t'ju paraqes një parashtrim të arsyeve se përse ne e shohim si të rëndësishëm dhe pse Holanda e mbështet këtë modul trajnimi.

Besimi në institucionet publike dhe në shtetin e së drejtës është i domosdoshëm për një demokraci të shëndetshme dhe për arritjen e mirëqenies. Besimi në institucionet publike dhe në shtetin e së drejtës përfshin një tërësi organizatash me funksione dhe përgjegjësi të ndryshme.

Në këtë aspekt policia është shumë e rëndësishme. Përse? Sepse policia është tepër prezente. Në momentin që një qytetar/e del nga shtëpia e tij/ saj në rrugët e qytetit ose fshatit, mundësitë që ai/ ajo të shohë, takojë ose ndërveprojë me policinë janë të larta. Detyra për të shërbyer dhe mbrojtur, kërkon prezencë publike.

Kur ne flasim për të siguruar besim në institucionet publike në shtetin e së drejtës, besimi tek policia është kritik. Si ta sigurojmë besimin në institucionin e policisë? Llogaridhënia, transparencja dhe integriteti janë kyçe.

Për sa i përket llogaridhënies dhe transparencës, do të doja të përgëzoja përpjekjet e bëra tashmë përbrenda forcës së policisë me qëllimin për të qenë më të hapur e të aksesueshëm nga publiku.

Një shembull i veçantë që kujtoj janë takimet e ashtuquajtura si “trekëndëshi” apo “takimet llogaridhënëse publike” – të organizuara nga IDM me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta – ku qeverisja vendore, policia dhe prokuroria takohen me qytetarët me qëllimin për të diskutuar mbi problematika të komunitetit dhe për të dhënë përgjigjet e kërkuara. Duke zhvilluar diskutime të tilla të hapura, institucionet mund të performojnë më mirë dhe të arrijnë të përmirësojnë sigurinë publike.

Kam ndjekur nga afër disa nga këto takime ashtu siç kanë bërë dhe disa kolegë të tjerë të institucionit që unë përfaqësoj. Disa prej tyre rezultuan në shkëmbime intensive, disa mundësuan informacione të rëndësishme mbi të cilat policia mund të punonte dhe disa të tjera mundën të qartësonin mbi vendim-marrje të caktuara për çështje të sigurisë të ndërmarra nga njësitë e qeverisjes vendore.

Në mënyrë që siguri i transparencës dhe lufta ndaj korrupsionit të jetë e vazhdueshme është e rëndësishme që dhe të mësuarit të jetë i vazhdueshëm.

Kjo është arsyeja pse jam e lumtur të jem pjesë e aktivitetit të sotëm të prezantimit të moduleve të reja mbi Etikën dhe Integritetin Policor dhe të sesionit të parë Trajnim për Trajnerët, mbi këto module, në Akademinë e Sigurisë.

Ky program trajnimi është rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm ndërmjet IDM-së dhe Akademisë së Sigurisë teksa e vlerësoj vendosmërinë e Akademisë së Sigurisë kundrejt zbatimit të kësaj qasjeje.

Programi i trajnimit mbi Etikën dhe Integritetin Policor është ndërtuar mbi kurrikulat e mëparshme të trajnimeve mbi etikën dhe mundëson një program të rifreskuar dhe praktik për oficerët e policisë të çdo grade dhe të çdo njësie vendore. Jam e kënaqur që ne mund të mbështesim zhvillimin e këtyre moduleve trajnuese të cilat do të shërbejnë si trajnime të vazhdueshme mbi etikën dhe integritetin e Policisë së Shtetit.

Shqipëria ka bërë shumë hapa drejt forcimit të shtetit të së drejtës. Përforcimi i kulturës së integritetit në polici është një kontribut i rëndësishëm kundrejt këtyre hapave. Këto përpjekje janë gjithashtu shumë të rëndësishme në kontekstin e rrugëtimit të Shqipërisë drejt integritimit në BE.

Më lejoni të jem e qartë, mbështetja Holandeze për perspektivën evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, është e palëkundur në këtë drejtim. Kjo është arsyeja se pse ne jemi këtu për të mbështetur Shqipërinë – kudo të jetë e mundur – që ajo të arrijë qëllimin e saj. Projekti që jemi duke mbështetur mbi integritetin në polici dhe projekte të tjera në fushën e integritetit janë pjesë e saj.

Ne ju inkurajojmë, si ekspertë dhe lektorë të Akademisë së Sigurisë, të promovoni aktivisht të mësuarit në vazhdimësi dhe të keni ndërveprime të hapura me kolegët tuaj, punonjës policie, mbi shqetësime dhe sfida të policimit etik.

Ne mbështetemi tek ju, që po merrni pjesë në këtë trajnim sot, dhe në vijim do të trajnioni kolegët tuaj, për të kontribuar në ndërtimin e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës të cilat në fund rezultojnë në institucione publike të besueshme dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Përgjatë kësaj rrugë, do të na gjeni gjithmonë në krahun tuaj.

FJALA PËRSHËNDETËSE E REKTORIT TË AKADEMISË SIGURISË, DREJTUES I LARTË Z. BILBIL MEMAJ

Në fjalën e tij, Rektori i Akademisë Sigurisë, Drejtues i Lartë z. Bilbil Memaj theksoi se prezantimi i moduleve të Trajnimit për “Etikën dhe integritetin në Policinë e Shtetit” vjen si rezultat i një pune të gjatë dhe një bashkëpunimi të ngushtë midis Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Akademisë së Sigurisë.

Një falënderim i veçantë shkon për Ministrinë e Jashtme të Vendeve të Ulëta (Mbretëria e Holandës) si mbështetëse e projektit “Ndërtimi i integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit”. Faleminderit grupit të punës që bëri të mundur përgatitjen e këtij moduli me rendësi të madhe për punonjësit e policisë.

Ky trajnim fillon sot me trajnimin e trajnerëve në Akademi dhe më pas do të shtrihet me trajnimin e të gjithë punonjësve të policisë sipas sistemit kaskadë në çdo Drejtori Vendore të Policisë.

Pjesë përbërëse e këtyre Moduleve do të përfshihen edhe në Programet Mësimore në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, si dhe Kolegjin e Lartë të Policisë Akademisë së Sigurisë.

AKADEMIA E SIGURISË



Për të pasur mbështetjen dhe besimin e publikut, Polica e Shtetit duhet të veprojë, krijojë e ruajë, imazhin e një organizate ku oficerë/et e policisë respektojnë dinjitetin njerëzor, në të gjitha veprimet e tyre, respektojnë këdo si një individ me të drejta dhe detyrime, si dhe trajtojnë çdo anëtar të komunitetit pa paragjykim.

Nëpërmjet veprimeve dhe shembullit të tyre ata promovojnë vlerën qendrore të demokracisë, barazinë nominale të gjithëve para ligjit. Ata janë proporcionalë në të gjitha veprimet e tyre dhe veprojnë në mënyrë të paanshme dhe në interes të të gjithëve. Punonjësit e policisë në zbatimin e detyrës varen nga ligji që ata vetë zbatojnë në publik, nuk bëjnë dhe nuk duhet të bëjnë diferencim për shkak të njohjeve apo për shkak të ndërhyrjeve. Ata janë të detyruar të punojnë, në mënyrë transparente dhe mbajnë përgjegjësi personale. Veprimet e tyre ndikojnë në besueshmërinë në publik të organizatës së policisë në përgjithësi, ndaj ata duhet të jenë korrekt.

Trajnimi do të ndihmojë në përmirësimin e kulturës dhe etikës së organizatës së Policisë së Shtetit, duke inkurajuar punonjësit e policisë që të krijojnë një organizatë etike dhe profesionale, që

të operojnë me integritet, për të evituar praktika jo të mira, sjelljet të pahijshme apo edhe të kundra ligjshme.

Ky manual do të jetë pjesë e kurrikulave të Akademisë së Sigurisë, moduli do të përfshihet në trajnimet që ajo zhvillon. Ne jemi të bindur se me zhvillimin e këtij moduli dhe përfundimit me sukses të këtij kursi çdo punonjës policie do të jenë në gjendje të :

- Të kuptojnë rolin e policisë në një shoqëri demokratike;
- Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e kulturës policore dhe ndikimin që ajo ka në sjelljen dhe vlerat policore;
- Të kuptojnë dhe diferencojnë konceptet themelore që lidhen me integritetin dhe etikën e policimit;
- Të përkufizojnë dhe bëjnë dallimin mes korrupsionit dhe sjelljes devijante;
- Të bëjnë dallimin midis sjelljes së pahijshme dhe korrupsionit;
- Të identifikojnë dilemat etike për alternativat që ekzistojnë kur oficerët e policisë vërejnë një veprim korruptiv.

Në fund çdo pjesëmarrës do të pajiset me një “Udhëzues mbi Manualin e Trajnimit për Integritetin Policor” i cili do të shërbejë si mjet reference për punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës.

Më tej, Znj. Elsa Toska, në cilësinë e përfaqësueses të grupit të ekspertëve të IDM-së për hartimin e këtij programi trajnimit, evidentoi se programi i trajnimit për etikën dhe integritetin policor nga ana metodologjike është ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me grupin e punës në Akademinë e Sigurisë. Kurrikulat janë personalizuar sipas kontekstit kulturor shqiptar mbi çështjet e integritetit dhe mbi të gjitha janë orientuar sipas problematikave dhe shqetësimeve të punonjësve të policisë në nivel teorik dhe praktik. Njëherazi ato mbështeten dhe reflektojnë në përmbajtjen e tyre standardet më të mira evropiane të çështjeve të integritetit.

“Më vjen mirë që Akademia e Sigurisë e ka tashmë një kurrikul të tillë, për formimin në vazhdim në nivel të mirë-strukturuar. Personalisht besoj se çështja e integritetit është si fara që duhet të hidhet në mënyrë që të rritet pema, dhe ku ka më mirë se sa fara të hidhet në audienca akademike, ku realizohet drejtpërdrejt formimi profesional i funksionarëve publikë”- mesazh nga fjala e znj. Elsa Toska, anëtare e ekipit të ekspertëve të IDM-së për hartimin e kurrikulave të trajnimit për etikën dhe integritetin policor.

Gjithashtu, drejtori i IDM-së, Sotiraq Hroni, falënderoi Akademinë e Sigurisë dhe grupin e punës për bashkëpunimin në këtë punë serioze dhe të vlerësuar. Me tej ai shpjegoi se ky projekt, i mbështetur nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, ka nisur para disa vitesh ku fokusi ka qenë vlerësimi i integritetit dhe korrupsionit në Policinë e Shtetit. Dy raporte kombëtare botuar në vitet 2014 dhe 2016 janë studime reference

për politikë-bërjen dhe kanë ndikuar në këtë drejtim në mënyrë të veçantë për fuqizimin e luftës kundër korrupsionit. Projekti aktual ka në përbërjen e tij disa komponentë të mirë-integruar me njëri-tjetrin në funksion të objektivit kryesor për forcimin e integritetit institucional të policisë së shtetit.

Modulet e trajnimit janë një komponent shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm në këtë drejtim. Ato marrin më shumë vlerë nëse do të shiheshin edhe nga pikëpamja e planeve të integritetit të njërive të ndryshme policore po ashtu edhe të takimeve llogaridhënëse vendore në kuadër të partneritetit të “trekëndëshit”.

Të tre këta komponentë ndikojnë tek njëri-tjetri dhe çojnë drejt përmirësimit të kulturës së menaxhimit të organizatës në një shoqëri të hapur dhe demokratike. Ato ndikojnë njëherazi edhe në përmirësimin e performancës së policisë, përmirësimit të imazhit dhe besimit publik.

Aktiviteti vijoi me zhvillimin e trajnimit të parë me lektorët e Akademisë së Sigurisë. Programi i trajnimit mbi etikën dhe integritetin policor synohet të vazhdojë me tre trajnime rajonale për trajnerët e 12 drejtorive të qarqeve të Policisë së Shtetit.

PËRMBAJTJA E MODULEVE MBI ETIKËN DHE INTEGRITETIN

MODULI I: PËRBALLJA ME KORRUPSIONIN NË POLICINË E SHTETIT

Ky modul përmban informacione teorike dhe ushtrime praktike që synojnë të informojnë dhe ndërgjegjësojnë pjesëmarrësit lidhur me rolin e policisë në një shoqëri demokratike, integritetin dhe etikën me të cilën duhet të përmbushet ky rol. Moduli mundëson të kuptohet se kur cenohen integriteti dhe etika profesionale në policim, cilat janë sjelljet devijante dhe koncepti i korrupsionit. Përmes ushtrimeve dhe shembujve praktikë, ai mundëson identifikimin e situatave që të vendosin përballë dilemave dhe nxit të menduarit kritik mbi to.

MODULI II: SJELLJA POLICORE – SJELLJET E PAPËRSHTATSHME, PASOJAT E TYRE DHE RËNDËSIA E RAPORTIMIT

Ky modul përmban materiale teorike dhe ushtrime praktike mbi rolin e kulturës policore në sjelljet policore në përgjithësi, ato të papërshtatshme në veçanti, mbi pasojat e sjelljes së papërshtatshme policore si dhe rëndësinë e raportimit të tyre. Nën orientimin teorik, pjesëmarrësit udhëhiqen të mendojnë në mënyrë kritike mbi skenarë praktikë të shfaqjes dhe manifestimit të sjelljeve të papërshtatshme policore dhe ndërgjegjësohen për pasojat e tyre si dhe për rëndësinë e raportimit dhe parandalimit të këtyre sjelljeve.

MODULI III: IMAZHI PROFESIONAL DHE KULTURA ORGANIZATIVE POLICORE

Ky modul përmban njohuri teknike dhe ushtrime praktike mbi imazhin profesional dhe kulturën organizative policore. Moduli përqendrohet kryesisht në çështjen se si një organizatë policore mund të sillet dhe të veprojë në mënyrë etike. Përmes këtij moduli synohet nxitja e të menduarit kritik dhe reflektimi mbi sjelljet e papërshtatshme të policisë, për të kuptuar më qartë lidhjen midis integritetit dhe sjelljes konkrete.

MODULI IV: KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR MBI INTEGRITETIN POLICOR

Moduli përmban detyrimet që përcaktojnë dhe rregullojnë integritetin e policisë dhe elementet përbërës të tij. Moduli synon të shpjegojë kuadrin ligjor dhe rregullator për integritetin policor dhe aspekte të tij. Integriteti policor dhe aspekte të tij (përkufizimet dhe ndalimi i llojeve të ndryshme të sjelljes së papërshtatshme, vizioni, misioni dhe vlerat e policisë), janë përmbledhur në dy dokumentet kryesore mbi Policinë e Shtetit, ligjin organik dhe Rregulloren e Policisë së Shtetit.

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

TREKËNDËSHI POLICI-BASHKI-PROKURORI NË DIALOG TË HAPUR ME GRUPET E INTERESIT DHE KOMUNITETIN

Modeli i takimeve llogaridhënese për parandalimin e krimit të trekëndëshit polici-bashki-prokurori është zhvilluar tashmë në 19 bashki në vend. Ky instrument ka shërbyer për të nxitur një formë të hapur komunikimi të autoriteteve vendore me qytetarët dhe grupet e interesit mbi problematikat e rendit, sigurisë publike dhe zbatimit të ligjit. Në këtë kontekst, takimet llogaridhënese të radhës u zhvilluan për herë të parë në Bashkinë Fier dhe Bashkinë Elbasan, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të trekëndëshit institucional.

Ashtu si në takimet pararendëse, edhe në këto dy takime të fundit, kjo formë e re komunikimi u mirëprit nga të pranishmit përfaqësues të komuniteteve vendore, kryetar fshatrash, lagjesh, përfaqësues të institucioneve të arsimit, organizata joqeveritare e media. Pjesëmarrësit në këto takime shprehën mbështetjen e këtij modeli për të trajtuar problematikat dhe shqetësimet mbi rendin dhe sigurinë publike drejtpërdrejtë me institucionet përgjegjëse.

BASHKIA FIER: “BASHKITË DUHET TË MARRIN GJITHMONË E MË SHUMË PËRGJEGJËSI NË LIDHJE ME SIGURINË PUBLIKE DHE KËSHILLAT BASHKIAKË NEVOJITET TË JENË MË TË PËRFSHIRË NË PROBLEMET E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE”

Në vazhden e advokimit të politikave që i shërbejnë parandalimit të krimit, në muajin tetor 2019 në Bashkinë Fier u zhvillua takimi në modelin e trekëndëshit llogaridhënës Bashki - Polici – Prokurori.

Përfaqësuesja e Bashkisë Fier, Zëvendëskryetarja znj. Enkelejda Peshkëpia vlerësoi këtë takim të zhvilluar si të parin e kësaj natyre në Bashkinë Fier. Ajo shprehu besimin se siguria publike nuk është vetëm përgjegjësi e Policisë së Shtetit dhe se është e rëndësishme të ndërtohen mekanizma referimi në të gjitha institucionet. Kontribut në ruajtjen

e bashkëpunimit institucional, sipas saj, është dhe organizimi i takimeve periodike me përfaqësues të policisë dhe bashkisë.

Në prezantimin e punës së kryer dhe angazhimeve institucionale, Drejtori i Policisë Vendore Fier z. Andon Marko bëri me dije se në fillim të çdo viti policia e qarkut Fier përpilon strategjinë vjetore që ka synim të ofrojë një shërbim sa më të mirë ndaj qytetarëve, sipas modeleve më të mira.

Në vijimësi, përfaqësuesja e Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor znj. Violeta



Shkurta vlerësoi se bashkëpunimi midis institucioneve është vital dhe se komuniteti gjithashtu duhet të jetë aktiv. Për sa i përket përfshirjes së institucioneve arsimore para-universitare, ajo u shpreh se shkolla luan një rol të rëndësishëm në edukimin e të rinjve për të zbatuar ligjin dhe respektuar rregullat. Mbi pikën e fundit, kontribut i veçantë i shkollave është edukimi mbi respektimin e qarkullimit rrugor.

Në pjesën e dytë të takimit llogaridhënës, iu dha hapësirë qytetarëve pjesëmarrës për të shprehur komentet e tyre apo për të kërkuar informacion nga përfaqësuesit e institucioneve të pranishme. Dy prej problematikave që u ngritën nga qytetarët ashtu si edhe përfaqësuesit e institucioneve ishte siguria në shkolla dhe aksidentet automobilistike. Për këtë

fundit, nga qëndrimi i përfaqësuesve të institucioneve u evidentua që nevojitej një ndërveprim më i lartë ndërmjet policisë dhe bashkisë në rregullimin e qarkullimit rrugor urban dhe interurban.

Në pjesën e dytë të takimit llogaridhënës, iu dha hapësirë qytetarëve pjesëmarrës për të shprehur komentet e tyre apo të kërkuar informacion nga përfaqësuesit e institucioneve të pranishëm. Dy prej problematikave që u ngritën nga qytetarët ashtu si edhe përfaqësuesit e institucioneve ishte siguria në shkolla dhe aksidentet automobilistike. Për këtë fundit, nga qëndrimi i përfaqësuesve të institucioneve u evidentua që nevojitej një ndërveprim më i lartë ndërmjet Policisë dhe Bashkisë në rregullimin e qarkullimit rrugorë urban dhe inter urban.

BASHKIA ELBASAN: BASHKIA ELBASAN ANGAZH OHET NË NGRITJEN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË SI PARTNERË PËR MIRËQEVERISJEN VENDORE

Në muajin shkurt 2020, në Elbasan u zhvillua takimi llogaridhënës për parandalimin e krimit të Trekëndëshit Bashki-Polici-Prokurori. Ky takim u drejtua nga kryetari i Bashkisë, Drejtues të Policisë Vendore dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjithashtu në takim morën pjesë përfaqësues të komunitetit fetar, të Këshillit Bashkiak, administratorëve dhe kryepjeqve të njësive administrative, institucioneve

arsimore para-universitare, përfaqësues të shoqërisë civile, medias dhe qytetarë të interesuar.

Në fjalën hapëse të këtij takimi, Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Gledian Llatja përshëndeti organizimin e një aktiviteti të kësaj natyre. Ai solli në vëmendje kontributin e Bashkisë Elbasan në përpjekjen për mirëqeverisje. Bashkia e Elbasanit është një nga bashkitë e para



në vend që ka miratuar dhe zbaton planin e integritetit. Kryetari premtoi mbështetje për Policinë e Shtetit për më shumë rend dhe siguri publike. Z. Llatja kërkoi rritjen e ndërveprimit të bashkisë me qytetarin në të gjitha aspektet e qeverisjes. Ai shtoi se në zbatim të Ligjit për Vetëqeverisje Vendore bashkia do të investohet në organizime komunitare në mini-zona urbane brenda qytetit të Elbasanit.

Ai argumentoi si nevojë fuqizimin e policimit në komunitet duke rritur komunikimin me qytetarët përmes një bashkëpunimi më të mirë me administratorët e lagjeve apo dhe pallateve në të gjithë qytetin. Në mbështetje të kësaj perspektive ai kërkoi mbështetjen e Këshillit Bashkiak dhe qytetarëve.

Zëvendës drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan z. Alfred Shehu e vendosi theksin tek informimi qytetar për rolin e prokurorisë. Sipas tij, ka shumë qytetarë të cilët kallëzojnë raste që nuk përbëjnë vepra penale, dhe që mund të zgjidheshin në forma të tjera. Bashkëpunimi midis institucioneve, përfshi shkollat e tjera mund të ndikojnë në edukimin ligjor të qytetarëve. Ndërsa

për sa i përket problematikave sociale, z. Shehu bëri me dije që Qarku i Elbasanit mbante numrin më të lartë të vjedhjeve në vend. Parandalimi i vjedhjeve të banesave mbetet një prioritet vendor për të gjitha institucionet.

Nevoja për ndërveprim institucional edhe me qytetarët ishte fokusi kryesor në fjalën e përfaqësuesit të Drejtorisë së Policisë Vendore, z. Nushi. Ai argumentoi se parametrat e duhur të policimit në komunitet nuk mund të arrihen vetëm duke i kërkuar llogari institucioneve përgjegjëse apo aktorëve të tjerë, por nga një bashkëpunim i të gjithë aktorëve përgjegjës të përfshirë në proces.

Në përvojën e deritanishme, z. Nushi vlerësoi bashkëpunimin e suksesshëm të Policisë së Shtetit me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Duke vlerësuar gatishmërinë e Kryetarit të Bashkisë dhe drejtuesve të institucioneve vendore për të punuar në qasje novatore që përfshin qytetarët në mirëqeverisje edhe në ngritjen e strukturave komunitare, drejtori i IDM z. Sotiraq Hroni premtoi një angazhim shumë të madh dhe aktiv të organizatës në këto drejtime.

NGRITJA E STRUKTURAVE KOMUNITARE PËR NJË MJEDIS MË TË MIRË PËR SIGURINË PUBLIKE

Ngritja e strukturave komunitare dhe zgjedhja prej tyre e ndërlidhësit komunitar sipas të gjitha kërkesave të neneve 68 dhe 69 të Ligjit për “Vetëqeverisjen Vendore”, krahas të tjerave ndërton urën e komunikimit, bashkërendimit midis qytetarëve dhe institucioneve.

Marrëdhëniet e strukturave komunitare me institucionet:

- Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar vendosin raporte dhe mbështetje për veprimtarinë e bashkisë dhe institucioneve të saj,
- Ndërlidhësi merr detyra nga Këshilli dhe Kryetari i bashkisë, detyra që lidhen me misionin e strukturave komunitare.
- Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të lehtësojnë kontaktet dhe mundësojnë bashkëpunimin me institucione të ndryshme në komunitet, si institucionet mjedisore, shkollat, veçanërisht në kuadër të nismës së “Shkollës qendër komunitare”, me emergjencat civile, etj.
- Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar bashkëpunojnë dhe bëjnë të mundur një mjedis të mirë për policimin në komunitet duke kontribuar për sigurinë

publike.

- Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar ndihmojnë në zhvillimin vendor duke mobilizuar kontribute të ndryshme të qytetarëve dhe sektorit privat.

Urdhri Nr. 407 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për planifikimin dhe organizimin e shërbimeve të komisarateve të policisë mbi bazën e zonës policore” krijon një mundësi të artë për përmirësimin e ndërveprimit të strukturave të policisë së zonës me këshillat komunitar dhe ndërlidhësat.

Për shembull: Një zonë policore mund t’i përgjigjen dy ose tri këshilla komunitar vendor, të cilët, sipas ligjit zgjidhen me pëlqimin e komunitetit të zonës urbane. Për policinë kjo do të thotë shumë për sa i përket kontaktit me udhëheqësit e komunitetit, me qytetarët, për një komunikim dhe shkëmbim informacioni më të lirshëm dhe të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se do të flitet më shumë dhe më hapur për figurat e krimit të zonës policore. Po kështu, ndikohet në rritjen e besimit në komunikim dhe përgjegjshmëri të ndërsjellë publike midis policisë dhe komunitetit. Këtu në fakt gjendet edhe thelbi i policimit në komunitet.

VLERËSIM I AUTORITETEVE VENDORE MBI NEVOJËN E INSTITUCIONALIZIMIT TË TAKIMEVE LLOGARIDHËNËSE TË TREKËNDËSHIT BASHKI-POLICI-PROKURORI

Në periudhën nëntor - dhjetor 2019, IDM mori opinionin e kryetarëve të bashkive, drejtues të policisë së shtetit në nivel vendor dhe drejtues të prokurorisë së

rretheve gjyqësore në të gjitha qarqet e vendit mbi praktikën e takimeve llogaridhëse për parandalimin e krimit dhe forcimin e sigurisë publike.

Thuajse të gjithë të anketuarit konfirmuan dakordësinë e tyre për nevojën e mbajtjes së takimeve të tilla në mënyrë periodike si instrument në parandalimin e krimit, komunikimit me qytetarët për sfidat e sigurisë publike dhe rritjen e besueshmërisë publike. Në lidhje me këtë, **z. Niko Brahimaj, Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër**, pohon se *“Përfshirja e komunitetit në denoncimin e rasteve të shkeljeve ligjore nëpërmjet linjave të emergjencës policore është faktor që ndikon drejtpërsëdrejti në parandalimin e kriminalitetit, prandaj besojmë se, takimet llogaridhënëse ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin e krimit”*.

Ndërsa **z. Petrit Cano, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkalës së Parë Krujë**, e vlerëson në këtë mënyrë nismën e takimeve llogaridhënëse të “trekëndëshit”: *“Unë besoj në këto lloj takimesh dhe mendoj se ndikojnë pozitivisht në parandalimin e kriminalitetit. Nga këto takime përftohet më shumë informacion për gjendjen e kriminalitetit, rakordohen më mirë veprimet e institucioneve ligjzbatuese dhe krijohet një mundësi më e mirë për të luftuar në kohë veprat penale që shqetësojnë më shumë komunitetin.”*

Nga ana tjetër **z. Kastriot Gurra, Kryetari i Bashkisë Librazhd**, shprehet se *“Takimet llogaridhënëse Polici-Bashki-Prokurori përbejnë një metodë efikase për të parandaluar krimin. Në tryezë vendosen fakte dhe ndahen eksperiencia. Ky komunikim siguron vijueshmëri dhe rritje të bashkëpunimit, por ç’ka është më e rëndësishmja forcon rolet respektive në trajtimin e rasteve dhe parandalimin e atyre me tendenca kriminale.”*

Për sa i përket shpeshtësisë së këtyre takimeve të anketuarit vlerësojnë se këto takime mund të zhvilloheshin nga 1 deri në

3 herë në vit. Në mesataren e përgjigjeve të dhëna, më së shumti përfaqësuesit e bashkive, shpreheshin për një shpeshtësi deri në tre herë në vit të takimeve.

Në një pyetje drejtuar drejtuesve të policisë mbi institucionet më të rëndësishme në nivel vendor për bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, rëndësi e lartë i jepej bashkëpunimit me shkollat në parandalimin e krimit dhe sigurisë publike dhe me qeverisjen vendore e më pas media dhe shoqëria civile.

Ndërsa pyetjes *“A mendoni se bashkia që ju drejtoni ka kapacitetet dhe mundësitë për të bërë më shumë në forcimin e sigurisë publike?”*, përfaqësuesit e bashkive evidentonin kryesisht si mangësi kapacitetin institucional. Kjo më së shumti evidentohet në rastet e njëjësive të vogla të vetëqeverisjes vendore. Siç e thekson **z. Shuaip Beqiri, Kryetar i Bashkisë Konispol**, *“Bashkia Konispol është bashki e vogël dhe me kapacitete të pakta si financiare ashtu dhe njerëzore dhe në të gjitha fushat që ajo mbulon duhet bërë më shumë. Pavarësisht dëshirës për të bërë më të mirën për qytetarët e kësaj bashkie mendoj se ne si institucion, i vetëm pa bashkëpunimin e institucioneve të tjera e kemi të vështirë të realizojmë një forcim më të madh të sigurisë publike. Një bashkëpunim më i mirë me institucionet do të kishte rezultate më të shpejta e më të mira në këtë drejtim.”*

Nga ana tjetër, **z. Gledian Llatja, Kryetari i bashkisë Elbasan**, nënvizon se *“Duhet që bashkitë të kuptojnë rolin e tyre të rëndësishëm në çështjet e sigurisë publike duke ndërtuar të gjitha mekanizmat që ligji ia lejon dhe t’i hapin rrugë një procesi komunikimi me Policinë dhe Prokurorinë të cilat nga ana e tyre duhet të shohin tek institucioni i bashkisë njohësin më të mirë të problematikave të komunitetit. Komuniteti duhet të perceptojë*

bashkëpunimin e frytshëm dhe llogaridhënien e përbashkët të këtyre institucioneve për të pasur imazhin e një shteti të fortë me struktura të qëndrueshme dhe ndërvepruese por edhe të hapura për komunikim.”

Megjithatë përfaqësuesit e institucioneve vendore pranonin që edhe në kushtet aktuale në frymën e një ndërveprimi institucional, bashkia mund të japë kontributin e saj në parandalimin e krimit. Një prej përfaqësuesve u shpreh se “mund të punojmë akoma më shumë në ndërgjegjësimin komunitar dhe në vendosjen e vetë institucionit në një pozitë më qendrore në çështjet e sigurisë publike në nivel lokal edhe pse vitet e fundit shumë hapa para janë bërë në këtë aspekt”. Gjithashtu, në këtë drejtim, **z. Adriatik Mema, Kryetar i Bashkisë Skrapar**, ka thënë se *po shohin mundësinë e mbulimit të akteve rrugore kryesore të qendrës urbane me kamera monitorimi, ndonëse janë mundësitë financiare ato që shpesh pengojnë për realizimin e disa hapave që do të ndikonin në forcimin e sigurisë publike.*

Në këtë vlerësim, zyrtarët e pyetur përpos dakordësisë në thelb me modelin e takimeve llogaridhëse, shprehnin

edhe mangësitë apo nevojat në realizimin e këtyre takimeve. Këto përgjigje dhe komente janë të nevojshme për t’u konsideruar si një vlerësim paraprak në zbatimin e këtij mekanizmi ndërveprimi institucional dhe qytetar në rrafsh vendi.

Pyetjes “Shkurtimisht, çfarë do të sugjeronit për suksesin e kësaj përvoje?” ndër më kryesoret ishin asistimi teknik i këtij ndërveprimi, mbajtja e raporteve apo buletineve të dedikuara për sigurinë publike, promovimi i përvojave të mira, mbajtja e përgjegjësisë dhe serioziteti në pjesëmarrje nga secili institucion, apo roli pro-aktiv i qytetarëve në qeverisjen vendore.

Për sa i përket kësaj të fundit, një përfaqësues i Policisë së Shtetit artikuloi nevojën për “hapje më tepër të institucioneve policore për dëgjimin e zërit të qytetarëve”. Ndërsa, **z. Naim Lala, shef i komisaritit në Mirditë, thekson nevojën e unifikimit të veprimeve ndërmjet institucioneve për të bërë të mundur reagimin në një kohë sa më të shpejtë për zgjidhjen e situatave të krijuara.**

Përvoja e takimeve llogaridhëse të organizuara në thuajse një të tretën e njësisive të vetëqeverisjes vendore të vendit por edhe sondazhi i zhvilluar nga IDM dëshmon:

mbështetje të plotë nga të gjithë institucionet vendore, përpos atyre të “trekëndëshit”, të tilla si këshillat bashkiakë, institucionet arsimore, shoqëria civile dhe qytetarët; gadishmëri të të gjithë aktorëve të sipërmendur për nevojën e institucionilimit të kësaj praktike; vlerësimin e takimeve llogaridhëse si instrument i rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë publike dhe bashkëpunimit me qytetarët; domosdoshmërinë për investim tek parandalimi i kriminalitetit përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit qytetar.

Zbatimi i praktikës së takimeve të “trekëndëshit” nuk mbart asnjë kosto financiare për institucionet e përfshira

POLICI

BASHKI

PROKURORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands